

URDHËR
Nr. 218, datë 5.4.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare” të ndryshuar, të ligjit nr. 9000, datë 30.12.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të nenit 29 ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, zëvendës-ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, znj. Elona Gjebrea, për këto çështje:

- a) trajtimin dhe ndjekjen e procedurave për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare;
- b) nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës dhe të dokumentacionit shoqërues, për fitimin, rifitimin ose humbjen e shtetësisë shqiptare pranë Presidentit të Republikës;
- c) trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave për informacion nga persona fizikë dhe juridikë, shqiptarë dhe/ose të huaj, që kanë të bëjnë me shtetësinë shqiptare.

2. Kompetencat e titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për çështjet e përcaktuara në gerrat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij urdhri, do të ushtrohen nga data 6.4.2017, deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, znj. Elona Gjebrea.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Fatmir Xhafaj